

13

I n f o r m a c i o n

Kohet e fundit vihet re nje aktivizim i madh i diplomacise se Vatikanit karshi vendit tone. Nunca te tij ne vende te ndryshme, por dhe miq e te njohur u kane folur diplomateve tane jashte per kenaqesine e shprehur nga Selia e Shenjte per lejimin e ushtrimit te besimit fetar ne vendin tone si dhe deshiren per te vendosur marredhenie diplomatike me Shqiperine.

Ne kushtet kur vendi yne ka marrë vendime te rendesishme ne drejtim te respektimit te te drejtave te njeriut dhe besimit fetar ka filluar tanime te ushtrohet, por njekohesisht dhe ne kuadrin e perpjekjeve qe po behen nga ana jone per t'u pranuar me te drejta te plota ne KSBE dhe per te vendosur marredhenie diplomatike me TPE-ne, vendosja e marredhenieve diplomatike me Seline e Shenjte do te kete nje efekt shume pozitiv ne komunitetin nderkombetar e qeverite e shume vendeve, duke patur parasysht influencen e gjere te Vatikanit ne to. Nje hap i tille do te sherbente dhe per te treguar se vendi yne eshte angazhuar seriozisht ne thellimin e procesit te pakthyeshem te demokratizimit te jetes se vendit dhe do t'u hiqte nga dora nje arme te forte disa qarqeve te huaja qe po e perdorin kunder vendit tone.

Per sa siper mendojme qe ambasadoret tane ne Athine e Algjer te kontaktojne keto dite nuncat e Vatikanit e ne bisede e siper t'iu lene te kuptojne se do te mireprisnim ndonje kerkese nga ana e Vatikanit per te vendosur marredhenie diplomatike me vendin tone.

Tirane, me 22 janar 1990

V. Pulaaj  
S.



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

Ministri

15  
Tirane, me 2 gusht 1991


Eminence,

Kam nderin qe duke iu referuar bisedimeve te zhvilluara midis dy paleve, te transmetoj deshiren e Qeverise se Republikes se Shqiperise per te vendosur marredhenie diplomatike me Seline e Shenjte.

Qeveria e Republikes se Shqiperise afirmon angazhimin e vet per te respektuar ne marredheniet diplomatike me Seline e Shenjte te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga zbatimi i Kartes se OKB-se dhe te Konventes se Vjenes "Per Marredheniet Diplommatike" te vitit 1961.

Qeveria e Republikes se Shqiperise do te vleresoje lart nje pergjigje pozitive te shpejte per vendosjen e marredhenieve diplomatike dhe krijimin e te gjitha mundesive e leh-tesive per hapjen e perfaqesise se saj prane Selise se Shenjte, si dhe kryerjen e te gjitha funksioneve te veta ne kushte normale, ne perputhje me te drejten e praktiken nderkombetare, si dhe ne perputhje me ligjet dhe rregullat e shtetit prites.

Pranoni, Eminence, sigurimet e konsiderates sime me te larte.

  
Muhamet Kapllani

EMINENCES SE TIJ  
ZOTIT KARDINAL REV. MA  
ANGELO SODANO  
SEKRETAR I SHTETIT TE  
QYTETIT TE VATIKANIT



Roma nr.781 dt. 8.8.91

20

I dorezova Claudio Celit, zv.MPJ i Vatikanit, origjinalin e letres  
qe MPJ i yne i ka drejtuar sekretarit te Shtetit te Vatikanit, Sodam,  
lidhur me marrredheniet diplomatike. "e kete rast, Celi me tha: Se  
shpejti do t'u jap pergjigjen zyrtare e cila mund t'ju them parapra  
kisht se do te jete 100% pozitive. Pas kesaj do te bejme edhe komuni-  
katen e perbashket. Detajet e fundit do t'i bisedojme se bashku ne nje  
takim ku do te jete dhe MPJ Zhan Kui Torran. Me tej, ai vazhdoi:

Ne fund te gushtit mendojme te dergojme ne Shqiperi nje delegacion te  
Karritas italiane per te ndihmuar ne krijimin e struktures se ngjashme  
te Karritas shqiptare. Ne kete kuader, se bashku te hapim tri qendra  
(magazina) ne Tirane, Shkoder dhe Durres per t'i furnizuar qe tani  
me ushqime, veshembathje etj., per t'i shperndare me pas (sidomos gjate  
dimrit) popullsise lokale.

Ne fund Celi perseriti edhe njehere propozimin per te gjetur nje godine  
ne Shkoder per te hapur kolegjin e djemve ne shtator, me fillimin e vitit  
te ri shkollor, si dhe kerkesen per t'u dhene nje lokal per hapjen e nje  
zyre. Miroshi

21

Ministria e Punëve të Jashtme  
Mbërriti me 22.8.91  
Lidhje note Nr 1774  
Drejtoria 1  
Dega 1

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME  
Ambasada-ROME

Rome, me 16 gusht 1991

Nr. 186

L e n d a: Note e Sekretarise se Shtetit te Vatikanit per vendosjen e marredhenieve diplomatike me Shqiperine

*D. I.  
Te mos keti parasysh  
klote te shtetit per  
shpallje te marredhenieve  
te prapetit nota  
J. 22.8.91*


MINISTRISE SE PUNEVE TE JASHTME

( Drejtorise se vendeve fqinje-Z. Bashkim Dine )

T I R A N E

Bashkelidhur ju percjellim noten Nr.5944/91/RS te Sekretarise Shtetit te Qytetit te Vatikanit(Seksioni per marrjedhenie me shtetet) qe i dorezoi me date 16.08.1991,ambasadorit te Shqiperise,ne nje takim ne Vatikan,ministri i Jashtem i Vatikanit,MonsinJOR Tauran,ne pergjigje te Letres qe ministri i Jashtem i Shqiperise Muhamet Kapllani i dergonte me date 2 gusht 1991 kardinal Sodanos per vendosjen e marredhenieve diplomatike.Ne note shprehet gadishmeri per vendosjen e marredhenieve diplomatike dhe disa rregulla proceduriale qe ka Vatikani lidhur me perfaqesimin diplomatik.Bashke me noten MonsinJOR Tauran na dorezoi edhe nje projektdeklarate te perbashket me rastin e vendosjes se ketyre marredhenieve qe Santa Sede mendon te publikohet njekohesisht nga te dyja palet me date 7 shtator 1991.Jane ne pritje te pergjigjes sone,me note verbale dhe sa me shpejt.

A M B A S A D O R I  
( Dashnor Dervishi )







SEZIONE  
PER I RAPPORTI CON GLI STATI

**N. 5944/91/RS**

The Secretariat of State - Section for Relations with States - presents its compliments to the Ministry of Foreign Affairs of Albania and, with reference to the letter dated 2 August 1991, addressed to His Eminence Cardinal Angelo Sodano, Secretary of State, has the honour to communicate the following:

- 1) The Secretariat of State takes note with great satisfaction of the decision of the Government of Albania to establish diplomatic relations with the Holy See. At the same time, the Secretariat of State wishes to assure the Albanian Government of its own decision to establish the same relations with Albania at the level, respectively, of Ambassador Extraordinary and Plenipotentiary accredited to the Holy See and of Apostolic Nuncio accredited to the Government of Tirana.
- 2) With regard to the matter of precedence in the Diplomatic Corps, the Ambassador of Albania to the Holy See and the Apostolic Nuncio will follow the ordinary rules of International Law.
- 3) The Holy See accepts that the Ambassador of Albania may reside outside Rome, and that he may be accredited at the same time to other Governments or International Organisations; however, the person occupying the position of Ambassador to the Italian Government cannot be simultaneously Ambassador to the Holy See.
- 4) The Pontifical Representative accredited to the Government of Albania may be accredited at the same time to other Governments.

The Holy See is confident that the official relations established with Albania will be advantageous to both sides, and will serve to strengthen the bonds of collaboration and friendship between them, on both the national and international level.

The Holy See is certain that the Catholic Church will enjoy in Albania full freedom in the exercise of her spiritual mission in the Country and likewise the possibility of developing her collaboration with the Albanian Authorities in the educational and social field.

The Secretariat of State permits itself to enclose with the present Note a draft of a joint Communiqué, to be published on the same day in Tirana and in the Vatican, on a date to be fixed by common accord.

The Secretariat of State - Section for Relations with States - avails itself of the occasion to renew to the Ministry of Foreign Affairs of Albania the assurances of its highest consideration.

From the Vatican, 16 August 1991

The Ministry of Foreign Affairs  
**TIRANA**, Albania



Proposta di pubblicazione

-

Sabato 7 settembre 1991

alle ore 12,00.

1991

DRAFT OF JOINT COMMUNIQUE'

1. The Republic of Albania and the Holy See, being desirous of promoting bonds of mutual friendship, have decided of common accord to establish diplomatic relations at the level of Embassy and Apostolic Nunciature.

2. The Holy See and the Republic of Albania being desirous of promoting bonds of mutual friendship, have decided of common accord to establish diplomatic relations at the level of Apostolic Nunciature and Embassy on the part of Albania.



REPUBLICA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E PUNEVE TE JASHTME

Nr. 2033

Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes se Shqiperise i paraqet komplimentat e saj Sekretariatit te Shtetit te Selise se Shenjte dhe ne lidhje me noten e saj Nr.5944/91/RS, date 16 gusht 1991, ka nderin te beje te ditur:

1. Qeveria Shqiptare shpreh kenaqesine e saj te veçante per gatishmerine e treguar nga Selia e Shenjte per te shpallur se afermi vendosjen e marredhenieve diplomatike me Republikën e Shqiperise.

Me kete rast ajo rikonfirmon dhe nje here se nuncio apostolik dhe ambasadori i Shqiperise prane Selise se Shenjte do te ushtroj misionin e tyre ne perputhje me te Drejten Nderkombetare.

2. Persa i perket emerimit te ambasadorit dhe vendqendrimin te tij, Qeveria shqiptare eshte plotesisht dakord me Seline e Shenjte dhe do t'i permbahet praktikës se saj qe ambasadori shqiptar i emeruar prane Qeverise Italiane te mos jete njekohesisht i emeruar dhe prane Selise se Shenjte.

3. Qeveria shqiptare nuk ka ndonje kundërshtim qe perfaqesuesi i Selise se Shenjte, i akredituar ne Tirane, te jete i

SEKRETARIATIT TE SHTETIT  
SEKSIONI I MARREDHENIEVE  
ME SHTETET



29

- 2 -

akredituar edhe prane qeverive te shteteve te tjera.

Qeveria shqiptare shpreh gjithashtu bindjen se marredheniet diplomatike te vendosura ne Seline e Shenjte do te jene ne te mire te te dy paleve dhe do te sherbejne per forcimin e lidhjeve te bashkepunimit e te miqesise midis tyre ne shkalle kombetare e nderkombetare. Kisha katolike do te gezoje ne Shqiperi liri te plote ne ustrimin e funksioneve te saj ne vend si dhe mundesine per te patur lidhje e kontakte me autoritetet shqiptare ne fushen shoqerore dhe te edukimit.

Ministria e Puneve te Jashtme eshte dakord me Sekretariatit e Shtetit te Vatikanit per tekstin e komunikates dhe shpalljen me 7 shtator 1991 te vendosjes se marredhenieve diplomatike, qe do te publikohen njekohesisht ne Vatikan e Tirane.

Ministria e Puneve te Jashtme e Republikes se Shqiperise perfiton nga rasti t'i perserise Sekretariatit te Shtetit te Vatikanit sigurimet e konsiderates se saj me te larte.

Tirane, me 22 gusht 1991

1. P. ...  
27/8

1991 08 22



R. P. S. SH.  
MINISTRIA E PUNËVE TE JASHTIME  
AMBASADA - ROMË

Ministria e Punëve të Jashtme  
Mbërriti me 22-1-81  
Lidhje 3 Nr 170  
Drejtoria I  
Dega \_\_\_\_\_

Romë, 18 janar 1991

82

Nr. 35

### MBI TAKIMIN ME ZHAN LUI TORAN, MINISTER I JASHTEM I VATIKANIT

Me kërkesen e tij, u takova me Zhan Lui Toran, ministër i jashtëm i Vatikanit. Takimi u bë në selinë e ambasades së Vatikanit në Romë, me datën 18 janar 1991, ora 18<sup>00</sup>.

Në këtë takim ishte i pranishëm edhe shoku Gjovalin Shkurtaç. Ambasadori i Vatikanit në Romë, që është edhe dekan i trupit diplomatik, bëri prezentimet e rastit dhe nuk mori pjesë në bisedë.

Bisedën e hapì Monsinjor Toran, i cili tha:

Prej kohësh, Selia e shenjtë dhe vete Papa, kanë ndjekur me interesim zhvillimet në Shqipëri. Na vjen mirë që ky demokratizim po thellohet, prandaj edhe e kemi përshëndetur. Papa, të shtunën e kaluar, në predikimin e tij me rastin e fillimit të vitit të ri, permendi në vijë të përgjithshme "proceset fermente" që po ndodhin në Shqipëri, duke lënë të kuptohet se ai i njeh, i ndjek dhe uron që ato të ecin kështu. Urojme që këto masa të reja të kenë edhe reflekset e veta në marrëdhëniet e atyre paqë meshtarëve shqiptarë, si Troshani, Jubani etj.

Papa ka vlerësuar lart deklaratën e presidentit Alia, qysh në majin e vitit të kaluar që "ushtrimi i fese të mos quhet me krim kundër shtetit". Gjithashtu është vlerësuar lart pritja e Nene Terezës dhe premtimi që i ka bërë asaj presidenti Alia për të sjellë "suorat" e saj në Shqipëri.

Kanë pasur rëndësi të veçantë meshat e organizuara në Shkodër e gjetke, prandaj, kohët e fundit, të gjithë ambasadorët tanë në Komitetin Evropian e kanë shprehur se Shqipëria po afrohet çdo ditë e më tepër drejt Evropës, po i përmbush kërkesat e KSBE-së. Edhe funksionare të lartë të Vatikanit janë shprehur me fjalë të mira për zhvillimet në Shqipëri, si p.sh. Sodano në Konferencën e KSBE-së në Kopenhagë, e më vonë në atë të Nju Jorkut.



Hapi me i rendesishem ishte korespondenca midis Selise se Shenjte dhe peshkopit Troshani, sepse ajo nuk eshte thjeshte nje kortezi, por nje raport shpirteror, qe ka te beje me strukturat e organizimin e fese.

Nje jave pas letres sone, Troshani na ka derguar nje pergjigje me poste normale. Edhe ky fakt eshte me rendesi, sepse tregon qe ai tashti pas shume vuajtjeve, lejohet te komunikojte me neve. Nepermjet Troshanit e Jubanit kemi mesuar se ne Shqiperi ka mbetur nje realitet katolik, por qe ka nevojte per t'u ndihmuar me objekte meshe te domadoshme, si edhe per kontakte me Seline e Shenjte. Jane shume enqiklika fetare te Papeve, te cilat Troshani e te tjeret nuk i njohin, mirepo ato jane ushqimi shpirteror i tyre. Per kete arsye deshirojme qe, sa me pare, te dergojme ne Shqiperi nje nga funksionarte e Vatikanit, per nje vizite te shkurter njohese. Mendojme te jete njeri nga zevendesit e mij, i cili do te qendroje pak kohe, sa per nje bisede apo dreke 2 deri 3 oresh, ne shtepine e Troshanit apo diku tjeter, ne nje hotel etj. Natyrisht, si kontakti i pare qe eshte, ne duam qe te behet ne kushte normale, pa zhurme e buje, pa sjehle asnje shqetesim per qeverine shqiptare. Nuk deshirojme te shkaktohet asnje provokim; duam thjesht te mund te ndihmojme qe ky peshkop, tashme ne moshe te thyer, pas kaq mundimesh, te ndjeje nje sodidfaksion.

Me sa dime ne Troshani nuk ka bere asnje kritike ndaj regjimit dhe ka shprehur thjesht kerkesa shpirterore.

Tha se, i derguari i Vatikanit per te realizuar takimin me Troshanin do te kete nevojte per ndihmen e autoriteteve shqiptare per t'i siguruar edhe nje makine, ne menyre qe ta realizoje brenda dites vajtjen dhe kthimin nga vendi i takimit.

U lut qe kerkesen e tij t'ia transmetoj qeverise dhe kut te kem ndonje pergjigje t'ia bejme ate te njohur.

Ne vazhdim, e falenderova kardinalin per vlersimet pozitive qe beri per zhvillimet e fundit ne vendin tone, e vura shkurt ne dijeni per elementet kryesore te procesit te demokratizimit ne Shqiperi, si dhe per disa karakteristika te fese ne Shqiperi. I theksova faktin qe tek ne uniteti kombetar ka qene pramar ndaj ndjenjave te ndryshme

7024 0 1997



84

3

fetare, si dhe faktin qe te gjitha fete ne Shqiperi tradicionalisht kane qene autoqefale; ato jane ushtruar ne gjuhen amtare.

Lidhur me kerkesen e tij mbajta shenim.

Dashnor Dervishi

Rome, 18.1.1991



1991 - D. 18.1.1991

*Sh. Lano*  
*L. Pato* 3

S H E N I M

Me date 12.4.1991 prita ne takim Monsinjur Vincenzo Paglia sebashku me personat e tjere qe e shoqeronin. Ai vuri ne dukje se ne viziten e pare ne Shqiperi para disa javesh ishte takuar edhe me Presidentin Ramiz Alia, nga i cili kishte mbetur shume i kenaqur. Kete here para se te vinte ne Shqiperi kishte patur takime me Papen dhe Andreetin, po ashtu edhe me De Mikelis, nga i cili solli pershtypjet dhe pershendetjet miqesore. Per vete tha ai ne nje fare menyre ka si mision nderlidhje midis Papes dhe Andreetit.

Duke folur per demokratizimin, tha se ai po vazhdon ne Shqiperi dhe se Papa e ndjek me vemendje e simpati. Populli shqiptar gjate gjithë kohes ka demonstruar nje ndjenje te forte identiteti kombetar. Me teper se njehere ai u ka thene "Jo" te forte edhe fuqive te medha. Ne deshirojme qe Shqiperia dhe populli shqiptar te ruajne unitetin duke ecur perpara ne rrugen e demokracise. Vleresuan projektkushtetuten e re, ne menyre te vecante nenet per lirine e fese dhe te ushtrimit te saj. Tha se Shqiperia eshte nje vend i vogel ku ekzistojne tre besime fetare dhe ajo mund te perfaqesoje nje rast unikal te harmonise e te bashkejeteses se tre feve ne nje vend e komb te vetem. Ne nuk deshirojme kurre, tha Paglia, qe ne Shqiperi feja te kthehet ne nje faktor percarje si ne Liban apo gjetke, por ne te kunderten mbi fete te ngrihet uniteti dhe identiteti kombetar. Ne kohen tone kur disa qendrimet fetare sidomos ato fundamentaliste perbejne nje rrezik iminent sidomos ne disa rajone, por edhe ne shkalle nderkombetare, rasti i Shqiperise mund te perbente nje shembull pozitiv ne te kunderten.

Kur une i vura ne dukje se jemi perballe nje situate te veshtire ekonomike ne kete periudhe tranzicioni e procesesh te thella

demokratike, Paglia tha se Perendimi dhe Evropa i detyrohen Shqiperise dhe duhet ta ndihmojne ate. Shqiperia eshte sa nje province e Italise dhe me mundesi e potenciale te medha, por ajo ka nevoje per financime e ndihma, per te cilat ne nuk duhet te jemi te kursyer.

Gjate gjithë takimit binte ne sy nje fryme dashamirese dhe miqesore nga Vincenzo Paglia dhe atyre qe e shoqeronin, te cilet duke u larguar thane se ata do te takohen edhe me udheheqesin e PD-se Sali Berishen, te cilit do t'i flasin me te njejten gjuhe per nevojen e unitetit te popullit dhe vazhdimesine e proceseve demokratike ne getesi.

Tirane, me 13.4.1991



D.I  
18.8-91  
J

S H E N I M :

Sot, me date 18 shtator 1991 vjen ne Shqiperi i ngarkuari me pune i Vatikanit. Nisur nga jehona qe iu be vendosjes se marredhenieve midis Shqiperise dhe Vatikanit nga shtypi dhe propaganda e tyre, mendojme:

Dokumenti

1. Me date 19 shtator i ngarkuari me pune i Vatikanit te pritet ne Ministri nga zoti Ilir Boçka dhe takimi te filmohet e jepet ne televizion.

Dokumenti

2. Te botohet nje artikull ne gazeten " Bashkimi" per rendesine e vendosjes se marredhenieve diplomatike midis Shqiperise dhe Vatikanit.(Artikulli te shkruhet nga Xhovalin Shkurta).

Garantimi

3. Te jepet nje dreke nga zevendesministri Ilir Boçka ku te jete i pranishem edhe drejtori Bashkim Dino.

Tirane,me 18 shtator 1991

Nr 89

Shenimi: *Shenimi*

*Shenimi*  
*10.10.91*  
*si zot-deli*  
*MPS*  
*1.10.91*

Ne pritjen me te ngarkuarin me pune te Selise se Shenjte, Mon-Diego Causero, ky i fundit me ngriti sa me poshte:

- Shprehu mirenjohjen per sistemimin e tyre te shpejte, duke vene ne dukje mirekuptimin per veshtiresite ne te cilat ndodhemi ne sot.

- Perseriti kerkesen lidhur me dhenien e nje terreni ne rrugen "Labonoti" per ndertimin e nunciatures.

- Sigurimin ne Tirane te nje ndertese e cila mund te shndrohohet ne shkolle per vitin e ardhshem. Te gjitha shpenzimet do te perballohen nga Vatikani, ndersa tekstet mesimore do t'i nenshtrohen miratimit te organeve tona perkatese.

- Sigurimin e dy-tre apartamenteve per strehimin e disa prifterinjve e motrave te cilet do te punojne per ngritjen e shkolles. Tha se keto ceshtje ia ka ngritur edhe Kryetarit te Komitetit Ekzekutiv te Tiranës.

- Dhenien nga ana e PTT-se e dy linjave telefonike, nje per telefon dhe nje per fax.

Mendojme qe persa siper t'i jepen zgjidhje pozitive para se te vije nuncio i tyre ne Shqiperi.

Tirane, me 1 tetor 1991

*Fosly*

*Vatikani*  
*Bvu 1715*  
*Z. Ylli Bufi*  
*1.10.1991*



NUNTIATURA APOSTOLICA  
IN ALBANIA

N. 13-GA/91

*D. Nostini*  
*22.10.91*

*A.A*

Ministeria e Punoris e Jashtme  
Mbledhja me 22.10.91  
Lidhje \_\_\_\_\_ Nr 2278  
Drejtoria I  
Dega \_\_\_\_\_

26

The Apostolic Nunciature in Tirana presents its compliments to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Albania and has the honour to inform that the appointment of His Excellency the most Reverend Ivan Dias, titular Archbishop of Rusubisir, as Apostolic Nuncio to the Republic of Albania will be officially announced in Rome on Tuesday, October 22nd, at 12.00 noon local time.

The Apostolic Nunciature avails itself of this opportunity to renew to the Ministry of Foreign Affairs of the Republic of Albania the assurances of its highest consideration.

Tirana, October 21st, 1991. *se*

-----  
THE MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS  
OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

T I R A N A